

ANA LALAJ

**NDARJA ME SOVJETIKËT DHE ALEATJA E FUNDIT
E SHQIPËRISË KOMUNISTE***

**Përse mungoi Enver Hoxha në mbledhjen
e Bukureshtit, qershor 1960?**

Kursi i destalinizmit që ndërmori Hrushovi u pranua me dhimbje dhe me shumë rezerva nga E. Hoxha dhe nga udhëheqja shqiptare. Retushimet që u bënë në fasadën e politikës shqiptare herë pas here ishin shoqëruar prej tyre dhe me pakënaqësi. Por autoriteti i “partisë mëmë”, ndihmat e shumta ekonomike dhe mbështetja ndërkombëtare e Bashkimit Sovjetik ndaj Shqipërisë, kishin bërë që në të shumtën e rasteve pakënaqësia të mbahej e mbyllur në nivele të larta të Partisë Punës Shqipërisë (më tej PPSH). Në ndonjë rast kur revolta ishte shprehur, menjëherë ishte kërkuar ndjesë ndaj Hrushovit dhe udhëheqësve të tjerë sovjetikë. Në fund të fundit udhëheqësit shqiptarë kishin konkluduar se “pa mbështetjen e Bashkimit Sovjetik (më tej BS) nuk kemi ku të përplasim kokën”.¹

Ajo që ngjau në mbledhjen e Bukureshtit, në qershor 1960, dha shenjën e parë publike se udhëheqja komuniste shqiptare nuk pranonte të drejtohej në mënyrë të pakushtëzuar nga Moska. Përfaqësuesi shqiptar Hysni Kapo u vendos i vetëm, përballë sekretarëve të parë të partive komuniste të vendeve të Traktatit të Varshavës, të cilët u deklaruan në unison të plotë me Hrushovin. Dokumentet shqiptare të deklasifikuara kohët e fundit hedhin dritë mbi kthesën dramatike të Shqipërisë që filloi në mbledhjen e Bukureshtit e që nxorri në pah kontradiktat e Bllokut Komunist por dhe ndikoi në përçarjen e tij të mëtejshme.

Më 2 qershor 1960, Sekretari i Parë i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, N. Hrushov, i dërgoi një letër Komitetit Qendror të

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Ndërkombëtare *East - Central Europe in the Cold War, 1945-1989*, Varshavë, 16-18 tetor 2008.

¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë / Arkivi i Partisë (më tej: AQSh/AP) / Organet Udhëheqëse (më tej: OU), viti 1956, dos. 59, fl. 19.

Partisë Punës Shqipërisë (më tej: KQ i PPSH) ku njoftonte për një mbledhje “të përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore motra të kampit socialist” për “shkëmbim mendimesh në lidhje me gjendjen ndërkombëtare”.² Ai propozonte që kjo mbledhje të bëhej në Bukuresht gjatë kohës që atje do të zhvillonte kongresin Partia Punëtore Rumune (më tej PPR). Më 6 qershor 1960, E. Hoxha iu përgjigj pozitivisht ftesës duke bërë me dije se PPSH do të përfaqësohej nga një delegacion i nivelit të lartë, i cili do të kryesohej nga ai vetë.³ Por megjithatë në mbledhjen e Bukureshtit nuk shkoi E. Hoxha por Hysni Kapo.

Një pyetje mund të ngrihet: Përse E. Hoxha ndërroi mendim dhe nuk shkoi në Bukuresht? Një ditë pasi kishte marrë ftesën e Bukureshtit nga ambasadori sovjetik në Tiranë, Ivanov, më 5 qershor, E. Hoxha mori dhe një telegram,⁴ nga Liri Belishova, sekretare e KQ PPSH, e cila ndodhej në Kinë.⁵ Midis problemeve që Liri Belishova shtronte, tre ishin më kryesore:

1. Udhëheqësit kinezë u kishin folur me orë të tëra për mosmarrëveshjet e tyre me sovjetikët. Liria u ishte përgjigjur se “nuk ishte e autorizuar për këto bisedime”.
2. Udhëheqësit kinezë mendonin që mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore në Bukuresht “të bëhet më vonë”, pasi kjo mbledhje duhej të përgatitej mirë për tre-katër muaj “ashtu si mbledhja e Moskës e 1957”.

² *AQSH/AP*, Marrëdhëniet e PPSH me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik (më tej: MPKBS), viti 1960, dos. 2, fl. 4.

³ *Po aty*, f. 7. Në delegacionin e KQ të kryesuar nga E. Hoxha, sekretar i Parë i KQ të PPSH, merrnin pjesë: Mehmet Shehu, anëtar i Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe kryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH; Beqir Balluku, anëtar i Byrosë Politike të KQ të PPSH, zëvendëskryetar i parë i Këshillit të Ministrave dhe ministër i Mbrojtjes Popullore të RPSH; Behar Shtylla, kandidat i KQ të PPSH dhe ministër i Jashtëm i Qeverisë së RPSH.

⁴ Në atë kohë, ambasada shqiptare në Pekin nuk kishte lidhje direkte me radio me Tiranën. Praktika ishte që ambasada shqiptare në Pekin ia dërgonte mesazhet ambasadës shqiptare në Moskë dhe prej andej ato i dërgoheshin Tiranës zyrtare. Kjo vështirësi ndikoi negativisht në komunikimin Hoxha-Belishova.

⁵ Liri Belishova, sekretare e KQ të PPSH, ndodhej në Kinë si anëtare e një delegacioni parlamentar të kryesuar nga Haxhi Lleshi, kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, që do të vizitonte Mongolinë, Vietnamin e Veriut dhe Korenë e Veriut.

3. Udhëheqësit kinezë kërkonin të dinin qëndrimin e udhëheqësve shqiptarë për artikujt kinezë të botuar në prill 1960, pyetje së cilës Liria nuk i kishte dhënë përgjigje të drejtpërdrejtë.⁶

E. Hoxha e shtroi telegramin e Liri Belishovës⁷ për diskutim në Byronë Politike të PPSH. Ishte e njëjta ditë, 6 qershor dhe e njëjta mbledhje, ku u mor vendim edhe për vajtjen e delegacionit shqiptar të kryesuar nga E. Hoxha në takimin e Bukureshtit. Fryma e përgjithshme e diskutimeve ishte në mbështetje të Bashkimit Sovjetik. Vetë E. Hoxha u shpreh se i takonte Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ta shtynte ose jo mbledhjen e Bukureshtit dhe se delegacioni shqiptar në Bukuresht do të mbante qëndrimin që do të mbante edhe PKBS.⁸ Megjithatë E. Hoxha u ndje i vlerësuar nga mesazhet e kinezëve. Përfaqësuesit e një partie të madhe, siç ishte Partia Komuniste Kineze (më tej: PKK), i hapnin zemrën dhe indirekt i kërkonin mbështetje. Por po aq, ai u ndje edhe i shqetësuar. Dy partitë më të mëdha të kampit socialist kishin mosmarrëveshje ndërmjet tyre. Pas vdekjes së Stalinit edhe udhëheqësit shqiptarë kishin pasur rezerva ndaj politikës së Hrushovit për një varg problemesh. Pas Kongresit XX të PKBS këto rezerva ishin shtuar. Por udhëheqja shqiptare kishte zgjedhur të heshte, pasi si një parti e vogël nuk mund të kundërshtonte e vetme PKBS. Përveç kësaj, PKBS drejtonte të gjithë kampin socialist në Luftën e Ftohtë kundër Bllokut Perëndimor. Në këtë kontekst, Hoxha kishte vlerësuar se hierarkia e Bllokut Komunist me në krye PKBS duhej ruajtur. Në këtë situatë, udhëheqja shqiptare bëri disa retushe politike, por thelbi stalinist i vijës së saj mbeti i pandryshuar. Në mbledhje të mbyllura ajo kishte vlerësuar se “nuk kishte asgjë për të revizionuar në vijën e saj”⁹. Ishin këto arsye që në telegramin dërguar Liri Belishovës për kinezët, E. Hoxha shprehej se “ne i kuptojmë shumë mirë

⁶ *AQSH/AP* / Marrëdhëniet e PPSH me Partinë Komuniste Kineze (më tej: PKK), viti 1960, dos. 2. fl. 3. Letër e Liri Belishovës dërguar E. Hoxhës më 4 qershor 1960. Njëkohësisht, nëpërmjet Jorgjia Premit, anëtare e KQ të PPSH, Liri Belishova i dërgoi E. Hoxhës dhe një relacion të hollësishëm për bisedat me kinezët.

⁷ Telegrami i Liri Belishovës i vinte E. Hoxhës pas një telegrami që Gogo Nushi, kryetar i Sindikatave të Shqipërisë, që ndodhej në Kinë për të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Federatës Sindikale Botërore, ku shkruhej se mbledhja nuk kishte filluar për shkak të mosmarrëveshjeve ndërmjet delegacionit kinez dhe atij sovjetik.

⁸ *AQSH/AP*, OU, viti 1960, dos. 14. Mbledhja e Byrosë Politike më 6 qershor 1960.

⁹ *Po aty*, OU, viti 1956, dos. 39, fl. 4/1.

arsyet e kinezëve”; pjesëmarrja e tyre në konferencën e Bukureshtit është “e domosdoshme”; momenti kërkon që “të shtrëngojmë radhët rreth PKBS”; artikujt kinezë KQ i ka gjetur “shumë të mira”.¹⁰

Më 7 qershor 1960, E. Hoxha mori letrën e dytë të Hrushovit, ku informohej se disa parti kishin kërkuar shtyrjen e mbledhjes. Hrushovi kërkonte për këtë mirëkuptimin e udhëheqjes shqiptare dhe njëkohësisht i ftonte përfaqësuesit e PPSH të vinin në Bukuresht, për “të vendosur definitivisht datën e mbledhjes së konferencës”. Po në atë letër shtohej se “nuk përjashtoj shkëmbimi i mendimeve... pa marrë asnjë farë vendimi”.¹¹ Shtyrja e mbledhjes përforcoi te E. Hoxha dyshim se në marrëdhëniet ndërmjet PKK dhe PKBS kishte ndodhur një krisje e madhe. Ai e kishte kapur mesazhin e kinezëve në telegramin e Lirisë të 4 qershorit, se në mbledhjen e Bukureshtit jo thjesht do të shkëmbeheshin mendime për situatën ndërkombëtare, por do të merreshin dhe vendime për mosmarrëveshjet kino-sovjetike. Ai dyshoi se në të njëjtën mënyrë mund të procedohej edhe në takimin e përfaqësuesve të partive në Bukuresht. “Ata (sovjetikët-A.L.) duan përgjigje nga neve”,¹² u shpreh ai në mbledhjen e Byrosë ku diskutohej ky problem. Ndërkohë, informacioni për përfshirjen e mosmarrëveshjeve kino-sovjetike në axhendën e mbledhjes së Bukureshtit, E. Hoxhës nuk iu bë i njohur nga sovjetikët as në telegramin e parë e as në të dytin. Në to bëhej fjalë vetëm për situatën ndërkombëtare në përgjithësi.¹³ Ai jo për herë të parë u ndje i nënvleftësuar. Mosinformimi gjatë ngjarjeve në Poloni dhe Hungari, politika e afrimit me Jugosllavinë dhe vlerësimi që i bëhej Titos etj., ishin momente që Enver Hoxhës i kishin krijuar mjaft shqetësime dhe ai nuk mund t’i harronte kollaj.¹⁴ E. Hoxha vlerësoi se momenti ishte mjaft delikat pasi pjesëmarrja në mbledhje obligonte për prononcim të çdo delegacioni partie.

¹⁰ *AQSH/AP / MPKK*, viti 1960, dos. 2, fl. 7.

¹¹ *Po aty / MPKBS*, viti 1960, dos. 2, fl. 11.

¹² *Po aty*, OU, viti 1960, dos. 16.

¹³ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), viti 1960, dos. 532/19. Më vonë E. Hoxha do të informohej nga burime të sigurta se të gjithë sekretarët e parë të partive komuniste e punëtore që morën pjesë në Bukuresht ishin vënë në dijeni të axhendës së mbledhjes për diskutimin e marrëdhënieve kino-sovjetike.

¹⁴ Shih Ana Lalaj, “1956, Tronditje në Kampin Komunist”, *Studime historike*, nr. 1-2, 2007.

Pikërisht në këto rrethana, Hoxha bëri disa lëvizje taktike. U tërhoq nga delegacioni i Bukureshtit dhe zgjodhi të ndjekë me vigjilencë ngjarjet. Në këtë mënyrë ai i linte vetes më shumë kohë dhe mundësi për të llogaritur lëvizjet e ardhshme. Gjithashtu ai i ktheu menjëherë përgjigje Hrushovit se KQ i PPSH “është plotësisht dakord me shtyrjen e mbledhjes”, nuk përmendi pjesëmarrjen e tij në takimin e mundshëm midis përfaqësuesve të partive komuniste për “shkëmbim mendimesh” që propozonte Hrushovi dhe nga ana tjetër, njoftoi Komitetin Qendror të Partisë Punëtore Rumune se në kongres do të merrte pjesë një delegacion shqiptar i kryesuar nga Hysni Kapo, sekretar i PPSH.¹⁵ Kështu, edhe nëse bëhej mbledhja e partive komuniste, H. Kapo nuk ishte personi i autorizuar nga PPSH që mund të vendoste. Ai mund të “jepte mendim” vetëm për “kohën” dhe “vendin” e konferencës së ardhshme.

Delegacioni shqiptar u porosit që të mos përzihej dhe të mos bëhej palë në mosmarrëveshjet kineze-sovjetike në Bukuresht. Me këtë qëndrim të matur, udhëheqësit shqiptarë shmangeshin nga statusi i tyre i satelitit të pakushtëzuar në orbitën e PKBS. Ky përjashtim nga rregulli i përgjithshëm u bë i dukshëm në ditët e mbledhjes së Bukureshtit. Mungesa e E. Hoxhës në krye të delegacionit shqiptar ra në sy të të gjithë pjesëmarrësve. Ai ishte i vetmi delegacion partie që nuk kryesohej nga sekretari i parë (përveç Gomulkës i cili erdhi më vonë). Që në takimin e parë të Hysni Kapos me Juri Antropov¹⁶ dhe A. Mogiorosh¹⁷, biseda do të ishte e tendosur. Hysni Kapo do të bënte të paditurin për mbledhjen e partive komuniste që mund të organizohej pas kongresit të PPR, si dhe për prezencën e gjithë sekretarëve të parë në Bukuresht. “Po ta dinim mund ta kishim menduar dhe përbërjen e delegacionit tonë”,¹⁸ i tha ai Antropovit. Ndërsa Antropovi u përpoq të rreshtonte H. Kapon në anën sovjetike, duke i shpjeguar në këndvështrimin e tij për disa orë rresht

¹⁵ *AQSH /AP / Marrëdhëniet e PPSH me Partinë Punëtore Rumune (më tej: PRR)*, viti 1960, dos. 2. KQ i PPR u njoftua për pjesëmarrjen e delegacionit shqiptar më 11 qershor 1960. Delegacioni shqiptar që do të merrte pjesë në Kongresin e PPR dhe njëkohësisht në mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore në Bukuresht, kryesohej nga sekretari i PPSH Hysni Kapo dhe dy anëtarë të KQ të PPSH, Sulejman Baholli dhe Thanas Nano.

¹⁶ J. Andropov, në pranverë të vitit 1960 mbante postin e kryetarit të Departamentit për Lidhjen e Partive Komuniste dhe Punëtore të Vendeve Socialiste në KQ të PKBS.

¹⁷ A. Magiorosh, anëtar i Byrosë Politike të PK të Rumanisë.

¹⁸ *AQSh/AP / Mbledhja e Bukureshtit*, viti 1960, dos. 1, fl. 2.

çështjet e mosmarrëveshjeve me kinezët. Madje, në shenjë vlerësimi, Antropovi solli dhe shembullin e Liri Belishovës dhe Gogo Nushit,¹⁹ të cilët gjatë vizitës në Kinë, i kishin përcjellë këshilltarit të ambasadës sovjetike në Pekin të gjitha bisedat zyrtare me kinezët.²⁰ Ai e quajti qëndrimin e tyre “principlial” dhe u shpreh se Hrushovi kishte mbetur “shumë i kënaqur” etj. Me anëtarët e tjerë të delegacionit u morën zyrtarë të tjerë sovjetikë (Iliçevi, Satiukovi). Biseda e tyre kishte filluar me frazën provokative: “Besojmë se partia juaj ju ka informuar për mosmarrëveshjet kino-sovjetike..”²¹

Të gjitha këto biseda, H. Kapo ia përcolli me hollësi E. Hoxhës nëpërmjet radiogrameve të shumta, ndërsa ky i fundit i lexonte ato në Byro, duke bërë komentet përkatëse dhe duke iu shtuar dyshimet. Takimet e sovjetikëve me anëtarët e delegacionit shqiptar në Bukuresht, E. Hoxha i konsideroi si përpjekje për të bërë “fajtores udhëheqjen e PPSH se gjoja ajo nuk i kishte vënë në korrent” anëtarët e saj. Madje edhe lavdërimet e sovjetikëve për Liri Belishovën, sekretaren e PPSH, ka të ngjarë që ai t’i përjetonte si kundërvënie e sinjale për largimin e tij nga pushteti.²² Por pavarësisht se të gjitha rastet mbeten për t’u vlerësuar, dokumentet sugjerojnë se më e mundshme është që tek E. Hoxha, me kohë të jetë krijuar një “ferment anti-Hrushov”²³, që mezi priste të shpërthente diku. Momenti i parë i këtij shpërthimi ishte Bukureshti,

¹⁹ Gogo Nushi ishte kryetar i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë. Gogo Nushi kryesonte delegacionin e Bashkimeve Profesionale të RPSH në sesionin XI të Këshillit të Përgjithshëm të Federatës së Sindikatave Botërore, që do të mbahej në Pekin.

²⁰ *AQSh/AP/MPKK*. viti 1960, dos. 2, fl. 4.

²¹ *Po aty* / Mbledhja e Bukureshtit. viti 1960, dos. 1.

²² Pas vdekjes së Stalinit, mars 1953, ishin larguar nga postet e tyre drejtuese disa nga udhëheqësit komunistë stalinistë në vendet e Evropës Lindore: Matias Rakoshi (sekretari i Përgjithshëm i Partisë Punëtore Hungareze) në korrik 1956 ishte zëvendësuar nga Erno Gero e disa muaj më pas, në tetor 1956, nga Janosh Kadar; Boleslav Bieruti (sekretari i Përgjithshëm i Partisë së Bashkuar Punëtore të Polonisë) në mars 1956 kishte vdekur papritur në BS dhe ishte zëvendësuar nga Eduard Ohabi, dhe ky i fundit pas disa muajsh nga Vladislav Gomulka; Vulko Cervenkov në 1954 u zëvendësua nga Todor Zhivkov si sekretar i Parë i Partisë Komuniste Bullgare dhe më 1956 nga Antoni Jugov si kryeministër etj. Edhe E. Hoxha i frikej një fati të tillë. Arrijmë në një deduksion të tillë duke u nisur dhe nga pohimet e Hoxhës në mbledhjet e mëvonshme të Byrosë Politike dhe të plenumëve të KQ të PPSH.

²³ Ana Lalaj, “Shqipëria: Nga Pakti i Varshavës në NATO”. Kumtesë e mbajtur në konferencën *Shqipëria në NATO*, Tiranë, më 10 shtator 2008.

kurse momenti i dytë ishte konferenca e Moskës, ku duke denoncuar drejtpërdrejt Hrushovin që nga ardhja e tij në pushtet, Enver Hoxha shkeli çdo rregull të disiplinës hierarkike në Bllokun Komunist.

Shqipëria del nga “rreshti”

Në Bukuresht H. Kapo, i udhëzuar nga E. Hoxha për çdo fjalë dhe qëndrim, e konsideroi “të parakohshme” mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore dhe kërkoi që të organizohet një mbledhje e ardhshme e partive komuniste dhe punëtore pas disa muajsh, “që të gjykojë se kush e ka drejt ose gabim”.²⁴ Duke vepruar në këtë mënyrë, delegacioni shqiptar mbështeti kërkesën e kinezëve për ta shtyrë mbledhjen për probleme të rëndësishme ndërkombëtare për të cilat PKBS dhe PKK kishin mosmarrëveshje. Në Bukuresht u arrit që mbledhja të shtyhej me argumentin “për përgatitje më të mirë”. Por në thelb, shtyrja do të thoshte se mbledhja e ardhshme do të ishte më e gjerë dhe diskutimi të hapej. Në të do të merrnin pjesë jo më 12 partitë e vendeve socialiste si në Bukuresht, por edhe parti të tjera komuniste dhe punëtore të Azisë e të gjithë botës. Ndërmjet tyre, PKK kishte përkrahësit e vet, gjë që presupozonte një rezistencë më të madhe ndaj Hrushovit e grupit të tij. Bukureshti përfundoi me një rreshtim të ri forcash, ku shumica e përfaqësuesve të partive ishin pro Hrushovit e kundër Kinës. Në këtë rreshtim Shqipëria zuri një vend të ri që do të merrte formë më të qartë e më të plotë në konferencën e Moskës.

“Humbja” e Hrushovit në mbledhjen e Bukureshtit i kushtoi Shqipërisë ftohjen e marrëdhënieve me BS, refuzimin e kërkesës për 50.000 ton grurë në korrik 1960 (vetëm 10.000 ton u siguruan në tetor), ndërprerjen e ndihmave ushtarake etj. Shtypi sovjetik shkruante rrallë për Shqipërinë. Jashtë shtetit, diplomatët sovjetikë filluan të silleshin ftohtë ndaj diplomatëve shqiptarë.²⁵

Ndërsa në Shqipëri, udhëheqja e PPSH ende pa filluar mbledhja e Bukureshtit njoftoi sekretarët e parë për mosmarrëveshjet kineze-sovjetike.²⁶ Më pas, Byroja Politike dhe KQ i PPSH u mblodhën disa herë

²⁴ *AQSh/AP* / Mbledhja e Bukureshtit, viti 1960, dos. 3.

²⁵ *AMPJ*, viti 1960, dos. 68/1.

²⁶ *AQSh/AP* / OU, viti 1960, dos. 16. Më 22 qershor 1960, ende pa filluar mbledhja midis partive komuniste dhe punëtore në Bukuresht, E. Hoxha u dërgoi të gjithë sekretarëve të parë të rretheve një letër ku i informonte për mosmarrëveshjet kineze-sovjetike, dhe për qëndrimin e drejtë që kishte mbajtur Byroja Politike e PPSH që kishte

radhazi për të analizuar mbledhjen e Bukureshtit, për të gjetur fajtorët, për të përcaktuar qëndrimet në të ardhmen. Gjithashtu u vlerësua qëndrimi “parimor” i delegacionit shqiptar i kryesuar nga Hysni Kapo në Bukuresht dhe përballë tij u vu qëndrimi i “gabuar” i Liri Belishovës në Pekin dhe Moskë.

Çështja Belishova

Më 31 maj 1960, një delegacion parlamentar i kryesuar nga Haxhi Lleshi, kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH, u nis për një vizitë miqësore në Kinë, në Vietnamin e Veriut, në Mongoli dhe në Korenë e Veriut. Në përbërje të delegacionit merrte pjesë dhe Liri Belishova, sekretare e KQ të PPSH dhe anëtare e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH, Lefter Goga, zëvendës/Kryetar i Presidiumit i Kuvendit Popullor të RPSH dhe Vasil Nathanaili, zëvendësministër i Jashtëm. Delegacioni parlamentar shqiptar arriti në Pekin më 2 qershor 1960. Në atë kohë në Pekin ndodhej edhe delegacioni i Bashkimeve Profesionale të RP të Shqipërisë, i kryesuar nga Gogo Nushi, anëtar i Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe kryetar i Bashkimeve Profesionale të RPSH, që do të merrte pjesë në sesionin e XI të Këshillit të Përgjithshëm të Federatës së Sindikatave Botërore. Por mbledhja që duhej të fillonte më 30 maj 1960, po shtyhej pasi në Kryesinë e Federatës kishte mosmarrëveshje.²⁷ Kinezët insistonin që të merreshin në konsideratë në mbledhje pikëpamjet e tyre për një varg çështjes të situatës ndërkombëtare, si bashkekzistenca paqësore ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, çarmatimi i përgjithshëm, lufta kundër imperializmit nuk është e pashmangshme etj. Udhëheqësit kinezë organizuan një varg takimesh me delegacionet miq, të cilëve u flisnin për pikëpamjet e tyre mbi këto probleme dhe për mosmarrëveshjet me PKBS. Takimet zhvilloheshin në sallat e KQ të PKK dhe zgjasnin me orë të tëra deri në të gdhirë.

propozuar mbajtjen e një mbledhjeje ndërkombëtare të përfaqësuesve të të gjitha partive komuniste e punëtore.

²⁷ Në rendin e ditës të këtij sesioni ishin dy çështje: 1. Zhvillimi i situatës ndërkombëtare, veprimtaria dhe detyrat aktuale të lëvizjes sindikaliste; 2. Kontributi i lëvizjes sindikaliste në luftën kundër kolonializmit. Në atë mbledhje merrnin pjesë 35 delegacione nga të gjitha vendet e botës, sidomos nga vendet e Afrikës së Zezë, Azisë dhe Amerikës Latine. Delegatë, të ftuar dhe personeli teknik i Federatës bëheshin gjithsej 300 vetë.

Më 4 qershor, në një nga këto mbledhje ishin të ftuar edhe Gogo Nushi me Liri Belishovën. Ata u tronditën nga kritikën e ashpra të shprehura nga udhëheqësit kinezë ndaj PKBS. Liri Belishova, nëpërmjet ambasadorit shqiptar në Pekin, Mihal Prifti, ftoi në një takim të ngarkuarin me punë të ambasadës sovjetike. Ai erdhi në ndërtesën e Legatës shqiptare në Pekin, dhe bisedoi me Belishovën dhe Gogo Nushin. Liri Belishova e informoi të ngarkuarin me punë të ambasadës sovjetike për qëndrimin e kinezëve në ato takime. Më 2 qershor për të njëjtin problem, Gogo Nushi i kishte shkruar edhe E Hoxhës. Duhet thënë se në rrethanat e atëhershme, takimet informative të udhëheqësve shqiptarë me sovjetikët ishin pothuajse ligjësi. BS konsiderohej “Koka e kampit socialist”.

Pra, takimi i Lirisë me të ngarkuarin me punë sovjetik nuk ishte ndonjë përjashtim nga rregulli. E veçanta qëndronte se në rastin konkret, Liri Belishova nuk ishte e informuar për letërkëmbimin Hrushov-Enver dhe për diskutimet e tendosura që po zhvilloheshin në Byronë Politike të KQ të PPSH. Kur Belishova ishte larguar nga Tirana për në Kinë, marrëdhëniet e PPSH me PKBS ishin miqësore. Këtë e dëshmon dhe një radiogram i E. Hoxhës dërguar Belishovës dhe Lleshit disa ditë pas mbërritjes së tyre në Pekin: “Po lexojmë përshëndetjet e shokut Haxhi në gazetë dhe këto na çuditën. Ato janë jashtëzakonisht të thata dhe me gabime. Pikësëpari, duhet të flitet më gjatë dhe jashtëzakonisht ngrohtë për Bashkimin Sovjetik dhe Kinën. E dyta, duhet të flitet si kurdoherë për rolin vendimtar të Bashkimit Sovjetik në çdo fushë.... Të gjitha përshëndetjet dhe fjalimet bajate që ju ka dhënë Ministria e Jashtme i grisni dhe formuloni krejt të reja”²⁸. Për takimin e mësipërm me të ngarkuarin me punë sovjetik, Liri Belishova njoftoi vetë E. Hoxhën. Madje ajo në fund të letrës shënonte: “Ju lutem shoku Enver, nëqoftëse do të keni gjë të më bëni radiogram”²⁹.

²⁸ *AQSh/AP / MPKBS*, viti 1960, dos. 2, fl. 1. Telegram i E. Hoxhës dërguar Liri Belishovës më 4 qershor 1960.

²⁹ *Po aty*, fl. 4. Telegram Nr. 63, i Liri Belishovës dërguar E. Hoxhës më 7 qershor 1960. Belishova në telegramin e saj shkruante: “Mbasi bisedova me shokun Gogo [Nushi], Mihali [Prifti] i tha gjatë pritjes që dha ambasada jonë, të ngarkuarit me punë të BS (ambasadori sovjetik lajmëroi se nuk do të vinte në pritje dhe aeroport se ishte i sëmurë), se unë desha të bisedoja me të. Ai erdhi në Legatë pas pritjes në orën 9.30. E takuam shoku Gogo dhe unë. Unë i shtrova se qëllimi i delegacionit tonë ishte ai që dihet, por shokët kinezë na shtruan neve ato probleme që u kishin ngritur dhe shokëve të sindikatave. E informova [të ngarkuarin me punë sovjetik] shkurt për ato që

Po atë ditë Liri Belishova u largua nga Pekini për në Hanxhou, ku u takua me Mao Ce Dunin³⁰, dhe vazhdoi vizitën në Shangai, në Vietnamin e Veriut, në Mongoli dhe në Korenë e Veriut. Vetëm në Phenian (Korea e Veriut), Liria arriti të lidhej me Tiranën (në Vietnamin e Veriut shërbimi me radio shifër me Shqipërinë mungonte). Ajo njoftoi menjëherë Hoxhën për vizitat e bëra si dhe për informacionin që kishte marrë nga Sekretari i Partisë i Shangait për “shtyrjen” e Mbledhjes së Partive Komuniste në Bukuresht. Ndërkohë në letër shënoi se “Gazeta dhe lajme nga Shqipëria s’kemi marrë.”³¹ Pra, nga 6 qershori³² deri më 23 qershor Liri Belishova nuk kishte marrë asnjë informacion nga Tirana për rrokullimën që kishin marrë punët në Bukuresht.

Është koincidence që po më 23 qershor, pas dy javë heshtjeje, edhe E. Hoxha i shkruajti Liri Belishovës. Ai ia dërgoi letrën me korrier të posaçëm. Kuptohet, përderisa letra është dërguar dorazi, ajo ka arritur më vonë se 23 qershori. Në atë letër të shkurtër, Hoxha përcillte atmosferën e tendosur të Bukureshtit por edhe një paralajmërim plot cmirë dhe kërcënues ndaj Lirisë: “Po të shkruaj këtë letër të vogël për të pasur kujdes të mos proncohesh për mosmarrëveshjet që ekzistojnë në mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës... Informatat tuaja që u keni dhënë sovjetikëve, sigurisht u ka ardhur mirë sovjetikëve dhe ju mburrin me të madhe, duke e quajtur gjestin tuaj “heroik”, “parimor” etj. Po ju bëjnë dhe do të të bëjnë shumë lëvdata. Natyrisht nuk duhet t’ju rritet mendja

na thanë ata [udhëheqësit kinezë] dhe për përgjigjet që u dhamë ne. Ai falënderoi me fjalë shumë të ngrohta për partinë tonë dhe tha se shokët kinezë me përjashtim të deklaratës së TASS për mosmarrëveshjet kinezo-hindiane, nuk ua kanë ngritur këto probleme themelore shokëve sovjetikë”.

³⁰ AMPJ, viti 1960, dos. 532/10, fl. 19.

³¹ Po aty, fl. 32

³² Po aty, fl. 12; AQSh/AP / MPKK, viti 1960, dos. 4, fl. 1. Më 6 qershor E. Hoxha i kishte dërguar Lirisë përgjigjen për udhëheqësit kinezë lidhur me konferencën e Bukureshtit. Por ka dhe një telegram tjetër të dt. 7 qershor që E. Hoxha ia dërgon “vetëm shokut Gogo”. Në të ai shkruan: “Morëm telegramin tuaj. Përsa i përket kontradiktave evito të proncohesh. Ato le të zgjidhen në rrugë partie, në mes partive të tyre. Çdo gjë mbroje në bazë të vijës së partisë sonë. Në fjalimin tënd mbro tezën sovjetike të çarmatimit, të traktatit të paqes me Gjermaninë, demasko imperializmin amerikan dhe revizionistët jugosllavë përçarës të çështjes së klasës punëtore”. Por kur Gogo Nushi mori telegramin, Belishova nuk gjendej në Pekin. Ajo ishte larguar për në jug, në Hanxhou e në Shangai. Më 9 qershor Gogo Nushi informonte Hoxhën se “I thashë Lirisë disa gjëra të telegramit tuaj në telefon”. (Shih AMPJ, viti 1960, dos. 532/10, fl. 19.)

nga këto lëvdata. Byroja Politike mendon (që kur na dërgove letrën dhe informacionin) se si ti edhe Gogua keni bërë gabim të rëndë përse i përket çështjes së informacionit. Ju nuk duhej të informonit pa marrë aprovimin e qendrës...”.³³ Këtë letër Liria e mori në Ulan Bator (Mongoli), kur po kthehej për në Moskë. Ajo letër ishte informimi i parë nga Tirana për Belishovën për mosmarrëveshjet e delegacionit shqiptar dhe atij sovjetik në Bukuresht.

Sapo Belishova arriti në Moskë, ambasadori shqiptar, Gac Mazi, i dorëzoi asaj një letër tjetër nga Hoxha, që mbante datën 28 qershor 1960.³⁴ Pra jo përpara se Liria të shkonte në Moskë, siç pretendon Ramiz Alia në librin e tij *Jeta ime*, por pasi kishte mbërritur atje. Edhe në atë letër nuk kishte ndonjë urdhër që Liria të mos ndalej në Moskë. Letra vinte pas mbledhjes së Bukureshtit (24-26 qershor 1960) dhe E. Hoxha e informonte Belishovën për ndarjen e madhe që kishte ndodhur midis partive komuniste dhe punëtore në Bukuresht dhe udhëzonte: “Do të të takojnë dhe do të bisedojnë që “të të sqarojnë”. Dëgjoji me kujdes, me gjakftohtësi dhe mos shfaq asnjë mendim... Çdo fjalë mate mirë dhe sa më pak fjalë aq më mirë”.³⁵

Në Moskë, delegacioni shqiptar i kryesuar nga Haxhi Lleshi u ftua nga Brezhnjevi për drekë. Në drekë së bashku me Haxhi Lleshin merrte pjesë dhe Liri Belishova dhe Rrapo Dervishi, atëkohë anëtar i KQ PPSH. Ndërsa nga pala sovjetike, më kryesorët ishin: Leonid Brezhnjev dhe Frol Kozllov, të dy anëtarë të Presidiumit të KQ të PKBS. Në drekë nuk u zhvilluan bisedime protokollare politike por, siç mund të pritej nga niveli i pjesëmarrësve të saj, diskutimet për ngjarjet politike aktuale nuk mund

³³ *AQSh/AP / MPKK*, viti 1960, dos. 2, fl. 40. Letër e E. Hoxhës dërguar Liri Belishovës më 23 qershor 1960.

³⁴ Ramiz Alia, *Jeta ime*, Tiranë: Botimet “TOENA”, 2010, f. 215-216. Në librin e tij me kujtime, R. Alia shkruan për Liri Belishovën: “Ajo shkoi në Ambasadën Sovjetike në Pekin dhe informoi ambasadorin rus për gjithçka i kishin thënë kinezët... Shoku Enver i shkroi një letër Lirisë që të mos ndalej fare në Moskë dhe të mos bisedonte me njeri për çështjen kineze... Kjo letër iu dërgua me korrier të posaçëm .. dhe iu dorëzua Lirisë diku në Ulan-Bator ose në Irkutsk, pra pa arritur Liria në Moskë... Ajo kërkoi takim me Hrushovin të cilit i raportoi jo vetëm për atë që i kishin thënë kinezët, por edhe për urdhrin që kishte marrë nga Tirana ...”. Këto dëshmi të R. Alisë nuk provohen nga dokumentet e kohës. R. Alia vazhdon ta shpjegojë historinë e Shqipërisë me klishetë e vjetra, ku ishte e zakonshme që faktet të deformoheshin në funksion të politikave të ditës.

³⁵ *AQSh/AP / MPKK*, viti 1960, dos. 2.

të shmangeshin. Kozllövi shfaqti pakënaqësinë e tij për qëndrimin e Hysniut në Bukuresht. Ai u shpreh se ishin “të ofenduar” nga qëndrimi shqiptar, se “është e drejta juaj të jeni me 201 milionët apo 601 milionët”, duke nënkuptuar BS dhe Kinën. Ndërsa Liri Belishova për t’iu shmangur temës së mosmarrëveshjeve ndërmjet BS dhe Kinës deklaroi se “ne nuk dimë si është zhvilluar mbledhja e Bukureshtit, po dimë një gjë se në qoftë se në jetën e Gomulkës ka pasur re, në jetën e Enver Hoxhës nuk ka pasur asnjë re. Udhëheqja e Partisë sonë ka qenë unike në pozitë e marksizëm-leninizmit dhe të miqësisë me BS..., do të bëhet mbledhja e nëntorit dhe atje do të zgjidhen këto gjëra...”³⁶ Por kujdesi i Lirisë për të vepruar edhe sipas udhëzimeve të E Hoxhës, por, edhe dreka me mikpritësit të mos prishej, nuk i frenoi sovjetikët për të ironizuar një deklaratë të Hoxhës për rrugën e ndërtimit të socializmit “pa zig zage”, e për t’u shprehur kundër “dogmatizmit” etj.

Por ngjarjet e mëvonshme dëshmuar se Liria në Moskë u ndodh në drekën e gabuar dhe në çastin e gabuar. Të gjitha bisedat, shakatë dhe dollitë e asaj dreke u bënë objekt i disa plenumëve, ku mediokriteti i anëtarëve të KQ të PPSH zhvlerësonte dhe mbyste çdo shprehje të lirë të mendimit dhe çdo gjykim ndryshe. Liri Belishova, e lavdëruara e sovjetikëve, u vendos para kryqëzimit. Të gjithë ishin unanimë në të zezën e tyre. U përziën bashkë miopia, urrejtja, zilia për gruan e jashtëzakonshme dhe energjike, që kishte arritur në majat e politikës shqiptare të kohës, por mbi të gjitha ndikoi përkeqësimi i marrëdhënieve shqiptare-sovjetike. Në Lëvizjen Komuniste Ndërkombëtare kishte disa vite që ishin kristalizuar dy rryma: ajo dogmatike staliniste dhe ajo e Kongresit XX të PKBS, e njohur ndryshe dhe Kursi i destalinizimit. Rrjedha e ngjarjeve dëshmoi se problemet midis PKK dhe PKBS ishin probleme të mëdha të Lëvizjes Komuniste Ndërkombëtare dhe kishin të bënin me zhvillimin e ardhshëm të saj. E. Hoxha iu shmang mbledhjes së Bukureshtit por nuk arriti t’i shmangej konfliktit të madh që kishte lindur. Bukureshti i tregoi Hrushovit se Shqipëria kishte dalë nga rreshti prandaj i duhej dhënë një mësim i mirë. Reagimi sovjetik pas Bukureshtit ishte i ashpër. Ai i ndërpreu Shqipërisë lëvrimin e sasisë së grurit të kërkuar, si dhe furnizimin me armatime në emër të Traktatit të Varshavës.

Në këtë zhvillim të ngjarjeve, edhe Hoxha kundërveproi në mënyrën e vet. Si lëvizje të mëtejshme të Hrushovit, Hoxha parashikoi

³⁶ *AQSh/AP / OU*, viti 1960, dos. 2.

daljen e vet nga skena politike. Në favor të këtij mendimi shkonin si informacionet që Hysni Kapo dërgonte nga Bukureshti për lavdërimet e Hrushovit për Belishovën, ashtu edhe informacioni i njëjtë i marrë nga Mehmet Shehu, i cili gjendej për kurim në Moskë dhe ishte takuar atje me Aleksei Kosiginin³⁷. Siç kishte ndodhur dhe do të ndodhte në të gjitha thyerjet ose kthesat politike të Shqipërisë, edhe kësaj here, ato do të shoqëroheshin me zakonet primitiv të kurbanit ose të flijimit. Radha ishte e Liri Belishovës. Hoxha manipuloi me rrezikun Belishova, si “provë e pakundërshtueshme” e ndërhyrjes sovjetike për përçarjen e udhëheqjes së PPSH. Për katër muaj rresht, çështja Belishova zuri vendin kryesor në axhendën e të gjitha forumeve të larta dhe të të gjitha organizatave bazë të PPSH. “Gabimet” e Lirisë i bënë ortek nga mbledhja në mbledhje. Fillimisht ajo u dënua për “nxjerrjen e sekretit”, më pas se “kishte thyer unitetin e udhëheqjes”, deri sa u arrit te akuza “për qëndrim armiqësor dhe në opozicion me vijën e Partisë”.³⁸ Nuk kishte “prova” të reja, kishte vetëm interpretime “të reja” në varësi të miqësisë së thyer shqiptare-sovjetike.³⁹ Duke lexuar plenumet e KQ PPSH në korrik, gusht dhe shtator të vitit 1960, ku mbizotëronte urrejtja, mllef, arroganca për kolegen e tyre, nuk ka se si të mos të kujtohen fjalët e Kurt Gregor, ministrit të Tregtisë së brendshme dhe të jashtme të Gjermanisë Lindore, në qershor të vitit 1953: “Ky nuk është Plenum, ky është Mathauzen”.⁴⁰ Këto episode i kushtuan Belishovës një persekucion të gjatë dhe të ashpër.

³⁷ Aleksei Kosigin (20 shkurt 1904 – 18 dhjetor 1980), zëvendës/Kryeministër i Bashkimit Sovjetik. Në një takim në spital në Moskë, Kosigini i kishte shfaqur Mehmet Shehut simpatinë e tij për qëndrimin e Liri Belishovës në Kinë.

³⁸ *AQSh/AP / OU*, V. 1960, D. 2.

³⁹ *Po aty*. Në mbledhjen e parë të Byrosë Politike, më 7 korrik 1960, ku Belishova raportoi me hollësi për vizitën e saj në vendet e Azisë, qëndrimi i Lirisë nuk kënaqi as E. Hoxhën dhe as anëtarët e Byrosë Politike të PPSH, të cilët kërkonin që ajo t’u ishte deklaruar më ashpër udhëheqësve të PKBS. Megjithatë mbledhja u mbyll me një qëndrim të ekuilibruar dhe të matur të Hoxhës drejtuar Belishovës: “Unë nuk mendoj kurrë dhe as më shkon në mendje se ti mund të kesh rezervën më të vogël përse i përket qëndrimit të Byrosë Politike për këto çështje...”. Në plenumet e mëvonshme Hoxha do ta akuzonte drejtpërdrejt Liri Belishovën se “donte t’i zinte vendin”.

⁴⁰ *Cold War International History Project Bulletin*, Issue 10, Washington D.C.: March 1998, f. 102.

PPSh dhe PKK në të njëjtën anë të barrikadës antisovjetike

Pas mbledhjes së Bukureshtit, në plenumet e partisë filloi të bëhej historiku i marrëdhënieve sovjetike-shqiptare që pas vdekjes së Stalinit dhe, të zbuloheshin të gjitha momentet kur PPSH ishte mbajtur në distancë apo ishte vepruar në dëm të interesave të saj. Qëndrimi i Hrushovit ndaj Kominformit, jugosllavëve, ngjarjeve në Hungari e Poloni, Venizellosit etj., u bënë çështje diskutimi në çdo plenum. U ndez një histeri akuzash ndaj Hrushovit e udhëheqësve të tjerë të PKBS, që nxirrte akoma më shumë në pah qëndrimin e dyfishtë të E. Hoxhës dhe të udhëheqësve shqiptarë ndaj “mikut të madh”. Në këto plume vazhdohej të deklarohesh se “nuk kemi konflikt ideologjik e politik me BS”,⁴¹ por në praktikë çdo shoqërim me sovjetikët i zyrtarëve të lartë deri te qytetarët e thjeshtë, filloi të konsiderohej “herezi” dhe të gjurmohej nga organet e sigurimit. Një ftesë e KQ të PKBS⁴² drejtuar KQ të PPSH për të dërguar një delegacion në Moskë për bisedime, u refuzua.⁴³

Ndërkohë një tablo tjetër paraqitej në marrëdhëniet e PPSH me PKK. Udhëheqësit shqiptarë ndjeheshin të vlerësuar nga miqtë e rinj kinezë. Ministri i jashtëm Çen I do t'i shprehej ambasadorit shqiptar në Pekin se: “Ne jemi të prekur nga qëndrimi i partisë suaj. Qëndrimi i partisë suaj na inspiron dhe inkurajon në punët tona”.⁴⁴ Më 1 tetor 1960, me rastin e 11 vjetorit të formimit të RP të Kinës, E. Hoxha mori pjesë në pritjen e ambasadës kineze në Tiranë, kurse më 29 nëntor 1960, me rastin e përvjetorit të çlirimit të Shqipërisë, Mao Ce Duni mori pjesë në pritjen

⁴¹ *AQSh/AP / OU*, viti 1960, dos. 2.

⁴² *Po aty / MPKBS*, viti 1960, dos. 2. Në letrën e KQ të PKBS dërguar KQ të PPSH, më 13 gusht 1960, midis të tjerash shkruhej: “Ne e quajmë të rëndësishme që në mbledhjen e ardhshme të nëntorit, PPSH dhe PKBS të shkojnë me një unitet të plotë mendimesh. Do të ishte e drejtë të shuhej në kohën e duhur shkëndija e keqkuptimit të lindur, në mënyrë që ajo të mos ndizet”.

⁴³ *Po aty*. Në letrën që KQ i PPSH i dërgonte KQ të PKBS, më 29 gusht 1960, midis të tjerash shkruhej: “Në mbledhjen e Bukureshtit qëndrimi ynë që i qartë, ai nuk u muar nga ne si rezultat i ndonjë “keqkuptimi”, sikurse bëhet aluzion në letrën tuaj, por u muar me ndërgjegje të plotë nga ana jonë dhe ne mbajmë të gjithë përgjegjësinë përpara popullit tonë dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare për këtë qëllim. ... Ne jemi të bindur se nuk jemi ne që prodhuam “shkëndinë e keqkuptimit” në mbledhjen e Bukureshtit. Partia jonë do ta thotë pikëpamjen e vet në mbledhjen e ardhshme të partive komuniste e punëtores...”. Letra iu dha edhe partive komuniste të Azisë dhe Evropës.

⁴⁴ *AMPJ*, viti 1961, dos. 168/2.

që dha ambasada shqiptare në Pekin. Qeveria kineze iu përgjigj menjëherë kërkesës së qeverisë shqiptare për të blerë 50 000 ton grurë.⁴⁵ Ndërsa në tetor 1960, qeveria kineze plotësoi një kërkesë tjetër të shqiptarëve për drithëra, ushqime dhe për një hua 1 500 000 dollarë pa përqindje. U shkëmbyen disa delegacione të ndërsjella ekonomike, kulturore, shëndetësore, etj.

Kjo atmosferë miqësore në marrëdhëniet shqiptare-kineze, u bë preludi i qëndrimit të E. Hoxhës në mbledhjen e Moskës. E. Hoxha, dhe në unison me të e gjithë udhëheqja shqiptare, e konsideruan PKK një alternativë të re në Lëvizjen Komuniste Ndërkombëtare. Thyerja kinosovjetike mundësoi shpërthimin e pakënaqësisë ndaj Hrushovit të akumuluar në vite të E. Hoxha dhe udhëheqësit shqiptarë. Mbështetja e gjithanshme ekonomike që Kina i dha Shqipërisë menjëherë pas Bukureshtit, si dhe qëndrimi i ngjashëm i PPSH dhe PKK ndaj Jugosllavisë, kultit të individit, çarmatimit etj, i vendosi të dy partitë në të njëjtën anë të barrikadës antisovjetike. Udhëheqësit shqiptarë e konsideruan PKK siguri për mbijetesë dhe në këmbim morën përsipër të ofronin shumë më tepër se ç'u mbanin shpatullat. Rrëmbimi dhe gjaknxehtësia me të cilin ata u përplasën me PKBS dhe roli që luajtën më vonë në Lëvizjen Komuniste Ndërkombëtare duke mbështetur “splitting parties” ose “partitë maoiste”, e dëshmon këtë.

Moskë 1960: Kinezët shkuan për t'u marrë vesh me sovjetikët, ndërsa shqiptarët për t'u ndarë

Fjalimi që E. Hoxha mbajti në Mbledhjen e Moskës, nëntor 1960, tanimë është i njohur. Me ndërgjegje ai doli “jashtë kufijve të Komunikatës”⁴⁶ për Konferencën, duke sfiduar hapur udhëheqësin e partisë më me autoritet të Bllokut Komunist. Rreshtimi politik i partive në Konferencën e Moskës, si mbështetës të PKBS ose të PKK, ishte shumë më i thellë se ai në Bukuresht. Kjo bëri që roli dhe pushteti i pasfidueshëm i PKBS në bllok të tronditej nga themelet. Udhëheqësit kinezë, pavarësisht se në minoritet, e ndjenë veten të fituar se i rrëshqitën

⁴⁵ *AQSh/AP / MPKK*, viti 1960, dos. 5; *AMPJ*, viti 1961, dos. 165. Më 1 gusht 1960, Çu En Lai, kryeministri i Kinës, në letrën drejtuar M. Shehut, kryeministrit të Shqipërisë, e njofton se qeveria kineze e kishte plotësuar kërkesën shqiptare për lëvrimin e 50 000 kv grurë për Shqipërinë.

⁴⁶ *AMPJ*, viti 1960, dos. 532/19.

izolimit në Lëvizjen Komuniste Ndërkombëtare. Madje lëshimet reciproke që delegacioni sovjetik dhe ai kinez i bënë njëri tjetrit për të përfunduar Deklaratën e konferencës së Moskës, dëshmonte për një rol të ri që po merrte PKK në Lëvizjen Komuniste Ndërkombëtare. Në kontekst të rirreshtimit të Bllokut, do të ishte interesante të analizoheshin akuzat kundër Hrushovit në fjalimin e E. Hoxhës, sa ato janë të vërteta, gjysëm të vërteta apo të pavërteta, por kjo i kalon caqet e kësaj kumtese. Dihet se vetë Hrushovi nuk i ktheu përgjigje akuzave shqiptare. Mendoj se kjo nuk erdhi për shkak të mungesës së “argumenteve” në anën e tij. Arsyet duhet të jenë më të thella, që qëndrojnë ndofta edhe në vetë dokumentet e Konferencës së Moskës për “unitetin” e “për të mos parë pas”.

Megjithatë përsa i takon Konferencës së Moskës, ajo që është pothuajse e papublikuar deri më sot, janë takimet sekrete, që delegacioni shqiptar i kryesuar nga Hysni Kapo ka bërë me delegacionin kinez, të kryesuar nga Ten Siao Pin, në Moskë, në tetor dhe nëntor 1960. Atëkohë, të dy delegacionet ishin pjesë e komisionit të krijuar për të përgatitur dhe për të redaktuar dokumentet kryesore të Konferencës së Moskës. Më 2 dhe 23 tetor 1960, me porosi të E. Hoxhës, do të organizohej takimi i parë i Hysni Kapos me Ten Siao Pinin në ambasadën kineze. Ata biseduan me hollësi mbi diskutimet që do të bënin, taktikën që do të ndiqnin dhe objektivat që duhej të arrinin gjatë punës së tyre. Ten Siao Pini sugjeroi se duhej të shfrytëzohej çdo mundësi që të provokohej diskutimi për të folur me “letra të hapura”, por duhej diskutuar “me maturi” “për pikëpamjet” dhe “pa emra”. Diskutimet duhej të kufizoheshin rreth Projekt-deklaratës.⁴⁷ Kur mori vesh propozimet kineze, Hoxha shfaqti menjëherë pakënaqësinë e tij. Në letrën drejtuar delegacionit shqiptar në Moskë, ai kërkonte një deklaratë “me barut” dhe “jo me pambuk”. “Shokët kinezë, shkruante Hoxha, i preokupon përshtypja dhe atmosfera që mund të krijohet nga sulmi i tyre te delegatët e Komisionit ose më vonë të konferencës. Kjo nuk është e mirë... Unë mendoj se fjalimet e Ten Siao Pinit tregojnë kërkesën e një kompromisi me sovjetikët”.⁴⁸

Gjithsesi, sot është i njohur fakti se në sajë të lëshimeve të ndërsjella kino-sovjetike, u arrit që nga Konferenca e Moskës të dilej me

⁴⁷ Ibid.

⁴⁸ AQSH/AP /MPKBS, Komisioni i Redaktimit, viti 1960, dos. 7.

një deklaratë, që edhe vetë E. Hoxha do ta shfrytëzonte më pas për të mbrojtur statusin dhe qëndrimet e tij ortodokse.

Sado i fraksionuar që ishte uniteti i arritur në Konferencën e Moskës, në muajt e ardhshëm qëndrimi i tejskajshëm i E. Hoxhës u bë shqetësim jo vetëm për sovjetikët, por edhe për kinezët. Madje vetë Mao Ce Duni do të shprehej se ata nuk mund të silleshin me sovjetikët si shqiptarët: “Lidhur me marrëdhëniet tona me BS, ne nuk do të adoptojmë domosdoshmërisht rrugën shqiptare. Kjo do të thotë se ne përdorim çdo mjet për të shmangur thyerjen dhe për të shtyrë thyerjen, dhe është mirë të mbajmë një situatë të jomiqësisë (unfriendliness) por jo thyerja të dalë në sipërfaqe”⁴⁹. Udhëheqësit kinezë do të merrnin iniciativën përpara Hrushovit në Moskë “për t’u dhënë këshilla shqiptarëve”. Ten Siao Pini do të këshillonte H. Kapon dhe R. Alinë që shqiptarët në fjalimet e tyre “të mos ndër marrin hapa ekstremë, në formë kategorike, të mos ngrinin tensionin, por të mbanin rezerva për manovrimet”. Madje ai arriti sa të propozojë që “ndoshta shoku Enver të marri iniciativën për t’u takuar me Hrushovin... pastaj mund të vijë edhe shoku Mehmet”. Ten Siao Pini shpjegoi se pas Bukureshtit udhëheqësit kinezë kishin vajtur katër herë në Moskë. Interesante janë edhe bisedimet e udhëheqësve kinezë me Gomulkën për Shqipërinë, të cilin e paralajmëruan se “do t’ju dënojmë në qoftëse do të ndërmerrni gjëkafshë kundër Shqipërisë nëpërmjet Traktatit të Varshavës”.⁵⁰ Udhëheqësit kinezë, me përgjegjësinë e përfaqësimit të një partie dhe të një shteti të madh, nuk do të hiqnin dorë nga qëndrimi për të bindur Shqipërinë edhe atëherë kur kriza kino-sovjetike do të thellohej. “Ne i kemi thënë dhe do t’i themi shokëve shqiptarë që marrëdhëniet ndërmjet jush duhet të përmirësohen dhe jo të keqësohen”⁵¹, i deklaronte Ten Siao Pin ambasadorit sovjetik në Pekin, Chervnonenko, në vitin 1961.

Sovjetikët menduan se PPSH, si një parti e vogël e një vendi të vogël, me burime njerëzore dhe natyrore të kufizuara, mund të thyhej nga presionet ekonomike dhe politike. Kompleksi i autoritetit të partisë së

⁴⁹ Dong Wang, “The Quarrelling Brothers: New Chinese Archives and a Reappraisal of the Sino-Soviet Split, 1951-1962”, *Cold War International History Project*, Working Paper, no 49, f. 62. Kjo deklaratë e Mao Ce Dunit për Shqipërinë është bërë në “mbledhjen e 7 mijëve”, më 11 janar-7 shkurt 1962, kur PK Kineze organizoi një mbledhje të madhe të punëtorëve, 7 000 kuadro të lartë.

⁵⁰ *AQSh/AP / MPKBS*, Komisioni i Redaktimit, viti 1960, dos. 10.

⁵¹ D. Wang, *art. i cit.*, f. 58.

madhe dhe të shtetit të madh e pengoi Hrushovin dhe udhëheqësit sovjetikë të manifestonin qetësi dhe maturi ndaj shqiptarëve pas Mbledhjes së Moskës. Në hierarkinë e atëhershme të Bllokut, një ofertë e vendosur sovjetike për pajtim do të thoshte që “shkopi rregullues të humbiste forcë”.⁵² Nga ana tjetër, kompleksi i dobësisë së partisë së vogël dhe të shtetit të vogël e detyronte E. Hoxhën dhe udhëheqësit shqiptarë ta ndjenin veten vazhdimisht të lënduar, të pasigurt dhe të reagonin me nervozizëm ndaj çdo padrejtësie të PKBS. Çdo iniciativë pajtuese nga ana e tyre konsiderohej si rrezik i shtuar për nënshtrim. Për këtë një rol të konsiderueshëm luante dhe afrimi i Hrushovit ndaj Titos dhe udhëheqjes së PKJ, të cilët nuk e fshihnin synimin e tyre, dhe madje punonin, për ta larguar E. Hoxhën nga skena politike shqiptare dhe për të vendosur në Shqipëri një udhëheqje politike miqësore me Jugosllavinë.

Nëse Shqipëria do të kapej fort pas PKK, që me kohë u kthye në një pol të dytë në Lëvizjen Komuniste Ndërkombëtare, kjo duhet konsideruar si një përpjekje për mbijetesë. Kurse për Kinën, Shqipëria si një vend evropian, anëtare e OKB, me një parti komuniste në pushtet, e cila kishte një qëndrim të vendosur antihrushovian, madje më të vendosur edhe se çdo parti tjetër komuniste aziatike, përfaqësonte një shans të mirëseardhur. Duke qëmtuar në motivet e kundërshtimit antisovjetik të udhëheqësve shqiptarë, konstatojmë se përkundër nevojës jetike për të qëndruar krah Kinës, ata krijuan edhe imazhin e gabuar se përfaqësonin një aset politik, një avangardë në Lëvizjen Komuniste Ndërkombëtare. Ndërsa udhëheqësit kinezë, të vetëdijshëm për nevojën e bashkëpunimit me BS përpiqeshin ta shtynin thyerjen përfundimtare dhe publike me udhëheqësit sovjetikë, shqiptarët e konsideronin luftën ndaj Hrushovit të pakthyeshme, deri në rrëzimin e tij. Prandaj për qëndrimin e kinezëve në Mbledhjen e Moskës dhe në Kongresin XXII të PKBS, shqiptarët patën shumë rezerva dhe e konsideruan atë vetëm një “mbrojtje të zbehtë”.

Në vitet pas Konferencës së Moskës, Hrushovi penalizoi Shqipërinë ekonomikisht, ushtarakisht dhe politikisht. Marrëveshjet ekonomike BS-Shqipëri u anuluan, nëndetëset e Traktatit të Varshavës u tërhoqën nga Baza e Vlorës. Marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë u ndërpreu. Megjithatë, Hrushovi nuk e përjashtoi Shqipërinë nga Traktati i Varshavës. Nëse sovjetikët u larguan paqësisht nga Baza e Vlorës dhe Perëndimi zbatoi politikën “Hands off” nga Shqipëria, kjo kryesisht ishte

⁵² *AQSh/AP / MPKBS*, viti 1960, dos. 10.

falë pozitës së saj strategjike, e cila rrezikonte shpërthimin e një konflikti me përmasa ballkanike dhe evropiane, që mund të dilte jashtë kontrollit të strukturave të sigurisë kolektive.

